

DISKURSI POLITIK & PUBLIK — MBI — DEKRIMINALIZIMIN

Raport monitorimi Janar – Mars 2026



Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke realizuar projektin “Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy). Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë përgjegjësi e ISP-së.

**Ekspert
Ardi Stefa**

@Instituti i Studimeve Politike

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE
Web: www.isp.com.al
E-mail: contactaips@isp.com.al

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

Hyrje	4
Metodologjia.....	4
I. DISKURSI POLITIK PËR DREJTËSINË DHE SPAK	5
i. Qëndrimet e qeverisë.....	5
ii. Qëndrimet e opozitës.....	5
iii. Tonaliteti: sulmues VS mbështetës VS delegjtimues	6
II. HETIMET DHE ÇËSHTJET NDAJ ZYRTARËVE TË LARTË	7
i. Rasti Balluku	7
ii. Rasti Ahmetaj, Veliaj, Meta, etj.	7
iii. Roli i SPAK dhe vendimet gjyqësore.....	8
III. MARRËDHËNIA POLITIKË – DREJTËSI.....	9
i. Ndryshime ligjore.....	9
ii. Retorika për “ <i>ndarjen e pushteteve</i> ”	9
iii. Konflikt institucional.....	9
IV. ROLI I FAKTORËVE NDËRKOMBËTARË.....	10
i. BE, SHBA, ambasadat.....	10
ii. Qëndrimet ndaj SPAK dhe korrupsionit	10
iii. Ndikimi në integrim	11
V. KLIMA POLITIKE DHE DISKURSI PUBLIK	11
i. Gjuha	11
ii. Protestat dhe dhuna	12
iii. Polarizimi politik.....	12
VI. DOMINIMI MEDIATIK I EDI RAMËS DHE SALI BERISHËS	12
i. Indeksi për dominim mediatic	13
ii. Dominimi sipas Platformave.....	14
iii. Indeksi i Polarizimit	14
VII. GJETJE DHE REKOMANDIME	15
i. Gjetje kryesore.....	15
ii. Rekomandime	16

Hyrje

Ky raport paraqet një analizë të diskursit politik dhe zhvillimeve kryesore në fushën e drejtësisë në Shqipëri gjatë periudhës janar–mars 2026. Fokusi kryesor i monitorimit është marrëdhënia midis aktorëve politikë dhe institucioneve të drejtësisë, veçanërisht në kontekstin e funksionimit të SPAK dhe hetimeve ndaj zyrtarëve të lartë.

Periudha e analizuar karakterizohet nga një intensifikim i tensioneve midis pushteteve, një përshkallëzim i gjuhës politike dhe një rritje e ndërhyrjeve dhe reagimeve politike ndaj vendimeve të drejtësisë. Në qendër të zhvillimeve qëndron rasti i zëvendëskryeministres B. Balluku, i cili shërben si katalizator për përplasjet ndërinstytucionale dhe për artikullimin e qëndrimeve politike ndaj drejtësisë.

Raporti synon të:

- identifikojë trendet kryesore të diskursit politik për drejtësinë;
- analizojë ndikimin e hetimeve ndaj zyrtarëve të lartë në klimën politike;
- vlerësojë marrëdhënien midis politikës dhe institucioneve të drejtësisë;
- evidentojë rolin e faktorëve ndërkombëtarë;
- analizojë ndikimin në klimën politike dhe diskursin publik.

Metodologjia

Monitorimi është bazuar në analizën sistematike të:

- edicioneve informative dhe emisioneve politike në televizionet kombëtare (Top Channel, TV Klan, News 24, Ora News, ABC News);
- artikujve dhe editorialeve në shtypin e shkruar (Gazeta Panorama, Gazeta Shqiptare, Gazeta DITA, Gazeta SOT);
- raportimeve të portaleve informative dhe investigative (Shqiptarja.com, Lapsi.al, CNA, Dosja.al, Newsbomb.al, BalkanWeb, BIRN, Reporter.al);
- deklaratave publike të politikanëve në konferenca shtypi, seanca parlamentare dhe rrjete sociale.

Mbi bazë monitorimi, *analiza* është zhvilluar përmes identifikimit të ngjarjeve kryesore që lidhen me drejtësinë dhe diskursin politik, të cilat janë trajtuar si njësi të veçanta analize. Këto zhvillime janë klasifikuar sipas pesë tematikave kryesore: i) diskursi politik për drejtësinë, ii) hetimet ndaj zyrtarëve të lartë, iii) marrëdhënia politikë–drejtësi, iv) roli i faktorëve ndërkombëtarë, v) klima politike dhe diskursi publik. Analiza është fokusuar në diskursin politik, duke shqyrtuar gjuhën e përdorur, tonalitetin, narrativat dhe qëndrimet e aktorëve, si dhe mënyrën se si drejtësia përdoret në komunikimin politik.

I. DISKURSI POLITIK PËR DREJTËSINË DHE SPAK

i. Qëndrimet e qeverisë

Gjatë periudhës së monitoruar (janar–mars 2026), diskursi i qeverisë, i përfaqësuar kryesisht nga kryeministri E. Rama, paraqet një evolucion të qartë nga një pozicion formal mbështetës ndaj drejtësisë, drejt një qasjeje gjithnjë e më kritike dhe përplasjeje të drejtpërdrejtë me institucionet e saj, veçanërisht në kontekstin e çështjes “Balluku”.

Në janar, reagimet e kryeministrit kanë qenë kryesisht në formë ironie dhe delegjitimimi të opozitës në raport me SPAK-un. Në fjalën e tij në Kuvend më 22 janar, ai ironizoi thirrjet e opozitës për kallëzime në SPAK, duke e cilësuar këtë institucion si: “*stacionin e fundit të rrugës së shpresës*”¹ për të ardhur në pushtet. Në shkurt, diskursi i qeverisë kalon në një fazë më konfrontuese, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e B. Ballukut. Kryeministri e cilëson këtë vendim: “*një budallallëk botëror*”² dhe paralajmëron ndërhyrje ligjore për të kufizuar efektet e vendimeve të tilla. Në të njëjtën linjë, ai shpall kabinetin si të paprekshëm nga masat e SPAK dhe argumenton se: “*Funksionet e padelegueshme kushtetuese... nuk mund të pezullohen kurrësesi nga askush...³*.” Retorika për drejtësinë intensifikohet më tej, duke përdorur terma delegjitimues si: “*fletët e arrestit plotësohen lehtësisht si ftesa dasmash*” dhe duke theksuar se administrata “*nuk është mish për top!*”⁴. Në mars, diskursi arrin nivelin më të lartë të përplases, ku kryeministri e cilëson drejtësinë si⁵: “*të anshme*” dhe “*jo profesionale*”, ndërsa për SPAK përdor formulime si: “*grupet hetimore të ‘stacionit të trenit’, që përdorin mediat si forca paramilitare*”. Paralelisht, ai mbron hapur vendimet politike për mosheqjen e imunitetit të Ballukut dhe i cilëson hetimet si “*gjyq publik*”⁶.

Megjithatë, në disa raste, diskursi i tij ruan një dualitet, ku nga njëra anë deklaron mbështetje për reformën në drejtësi: “*100 herë do zgjidhte reformën në drejtësi*”⁷, por nga ana tjetër paralajmëron ndërhyrje në të.

ii. Qëndrimet e opozitës

Diskursi i opozitës gjatë kësaj periudhe karakterizohet nga një përdorim i dyfishtë i drejtësisë dhe SPAK-ut, në varësi të interesit politik dhe zhvillimeve konkrete. Në janar, opozita shfaq mbështetje për hetimet dhe denoncimet, veçanërisht përmes figurës së A.

¹ <https://www.kryeministria.al/newsroom/parlament-fjala-e-kryeministrit-edi-rama-2/>

² <https://tvklan.al/pezullimi-i-ballukut-rama-nje-budallallek-botedor>

³ <https://www.reporter.al/2026/02/09/ndryshime-ligjore-rama-shpall-kabinetin-e-tij-te-paprekshem-nga-masat-e-spak/>

⁴ <https://shqiptarja.com/video/rasti-balluku-rama-mbledh-grupin-e-ps-prezantohen-ndryshimet-ligjore-qe-frenoje-gjykatat-te-pezulloje-ministrat-dhe-postet-kushtetuese>

⁵ <https://www.tpz.al/aktualitet/sngre-karton-qe-ti-hiqet-imuniteti-rama-per-ballukun-do-te-kete-ne-kr-i315139>

⁶ Po aty,

⁷ <https://shqiptarja.com/lajm/presionet-nga-gjyqesorit-rama-mua-me-ktheheni-me-deklarata-nervoze-ai-berisha-qe-ia-lexon-librin-e-shtepise-prokurorit-te-spak-si-thoni-asgje>

Ahmetajt, i cili akuzon kryeministrin si: “*kreu i organizatës*”⁸. I. Meta e cilëson Ahmetajn: “...një luftëtar për të ardhmen e Shqipërisë...”⁹ Opozita akuzon qeverinë për ndërhyrje në drejtësi dhe për përdorim të saj për mbrojtje politike. Megjithatë, paralelisht me këtë mbështetje, opozita përdor një gjuhë delegitimimi ndaj institucioneve të drejtësisë kur ato prekin interesat e saj. Në mars, S. Berisha deklaroi: “*De facto SPAK nuk ekziston më.*”¹⁰ Po ashtu, ai sulmon drejtësinë dhe e cilëson atë si të kontrolluar nga qeveria, duke pretenduar se është: “*në kontroll të plotë të kryeministrit E. Rama*”¹¹. Në disa raste, opozita kaloi në gjuhë ekstreme dhe personale, si në reagimin ndaj fjalimit të Ramës: “*SPAK-u është zero me bisht, se drejtësia nuk ekziston*”¹². Ndërkohë, kur kërkon arrestime apo hetime ndaj qeverisë, opozita e përdor SPAK-un si instrument politik duke e mbështetur atë në mënyrë selektive.

iii. Tonaliteti: sulmues VS mbështetës VS delegitimues

Gjatë periudhës janar–mars 2026, tonaliteti i diskursit politik në Shqipëri pëson një degradim të dukshëm, duke reflektuar një klimë të tensionuar dhe të polarizuar ndërmjet aktorëve kryesorë politikë. Komunikimi publik largohet nga standardet institucionale dhe racionaliteti argumentues, duke u karakterizuar gjithnjë e më shumë nga gjuhë ironike, denigruese dhe konfrontuese. Si qeveria ashtu edhe opozita përdorin narrativa që synojnë delegitimimin e kundërshtarit dhe të institucioneve, ndërsa drejtësia shndërrohet në një element qendror të përplasjes politike. Në këtë kontekst, tonaliteti i diskursit nuk shërben më si mjet komunikimi institucional, por si instrument për përf forcimin e konfliktit dhe mobilizimin politik.

Tonaliteti i qeverisë	Tonaliteti i opozitës
Ironik dhe delegitimues <ul style="list-style-type: none"> – “<i>stacioni i fundit i rrugës së shpresës</i>”¹³ – “<i>budallallëk botëror</i>”¹⁴ 	Ekstrem dhe akuzues <ul style="list-style-type: none"> – “<i>SPAK nuk ekziston më</i>”¹⁵ – “<i>zero me bisht</i>”¹⁶
Denigrues ndaj drejtësisë <ul style="list-style-type: none"> – “<i>fletët e arrestit si ftesa dasmash</i>”¹⁷ 	Personal dhe agresiv <ul style="list-style-type: none"> – etiketime, sulme personale, gjuhë jo

⁸ <https://lapsi.al/2026/01/09/intervista-skandalet-e-reja-te-korrupsionit-qe-denoncoi-arben-ahmetaj/>

⁹ Po aty,

¹⁰ <https://kohajone.com/lajme/sali-berisha-de-facto-spak-nuk-ekziston-me-protestat-rruga-e-vetme/>

¹¹ https://kohajone.com/lajme/sali-berisha-de-facto-spak-nuk-ekziston-me-protestat-rruga-e-vetme/?fbclid=IwY2xjawQyTwBLEHRuA2FlbQlxMABicmlkETFoUERpUnZ2QVRLdzhMMmFhc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHg3BYNDfW2tDZ5JhgtvL62TxU2ACkMteCCb6x_eyJpQeEaXbmNYVpk36Q8yn9_aem_KvIPq7KRnZ9H3ZWL45jZha

¹² <https://www.gazetatema.net/politika/lubia-e-paprekshme-spak-u-zero-me-bisht-berisha-fjalimi-i-rames-elegji--i548268>

¹³ <https://www.kryeministria.al/newsroom/parlament-fjala-e-kryeministrit-edi-rama-2/>

¹⁴ <https://vna.al/politika/rama-ne-mbledhjen-e-grupit-te-ps-ekspertize-nderkombetare-per-ceshtjen--i19828>

¹⁵ https://kohajone.com/lajme/sali-berisha-de-facto-spak-nuk-ekziston-me-protestat-rruga-e-vetme/?fbclid=IwY2xjawQyTwBLEHRuA2FlbQlxMABicmlkETFoUERpUnZ2QVRLdzhMMmFhc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHg3BYNDfW2tDZ5JhgtvL62TxU2ACkMteCCb6x_eyJpQeEaXbmNYVpk36Q8yn9_aem_KvIPq7KRnZ9H3ZWL45jZha

¹⁶ https://www.gazetatema.net/politika/lubia-e-paprekshme-spak-u-zero-me-bisht-berisha-fjalimi-i-rames-elegji--i548268?fbclid=IwY2xjawQb5KNleHRuA2FlbQlxMQBzcnRjBmFwcF9pZBAyMjlyMzcxNzg4MjAwODkyAAEeUyjNhUTfM096kGYXycz-l6vVqAxcSymOAi_vguisUKmw_49viRbJgS6Xzo_aem_LJuz7RDtauK1DRNOp96PgA

¹⁷ <https://shqiptarja.com/video/rasti-balluku-rama-mbledh-grupin-e-ps-prezantohen-ndryshimet-ligjore-qe-frenoje->

	etike
Polarizues dhe mbrojtës – mbrojtje e drejtpërdrejtë politike për zyrtarët e akuzuar	Konspirativ – akuza për kontroll të drejtësisë nga qeveria

Tabela 1_Tonaliteti i diskursit politik

Diskursi politik gjatë kësaj periudhe paraqitet i fortë, thellësisht konfliktual dhe i politizuar, duke reflektuar një klimë të tensionuar ndërmjet aktorëve kryesorë. Ai dominohet nga përdorimi i një gjuhe denigruese dhe emocionale, e cila shpesh zëvendëson argumentin institucional me narrativë përplasëse. Në këtë kontekst, drejtësia nuk trajtohet si një institucion neutral dhe i pavarur, por përdoret në mënyrë të vazhdueshme si instrument narrativ dhe politik në funksion të interesave të palëve.

II. HETIMET DHE ÇËSHTJET NDAJ ZYRTARËVE TË LARTË

i. Rasti Balluku

Rasti i zëvendëskryeminstres B. Balluku përbën boshtin kryesor të zhvillimeve gjatë periudhës janar–mars 2026, duke dominuar diskursin politik, institucional dhe mediatik.

Ngjarja kyçe është vendimi i Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e saj nga detyra, i cili shënon një moment kritik në marrëdhënien midis pushtetit ekzekutiv dhe sistemit të drejtësisë. Ky vendim u interpretua nga qeveria si ndërhyrje e pajustificuar në funksionet kushtetuese të ekzekutivit. Kryeministri Edi Rama reagoi ashpër ndaj këtij zhvillimi, duke e cilësuar vendimin: “një budallallëk botëror.¹⁸” Në vijim, ai artikuloi një qëndrim institucional duke theksuar se: “Funksionet e padelegueshme kushtetuese... nuk mund të pezullohen kurrësi nga askush...¹⁹” Çështja Balluku u përshkallëzua më tej me kërkesën për heqjen e imunitetit të saj, ku Kuvendi u përball me presion politik dhe institucional. Kryeministri mbajti një qëndrim të prerë kundër kësaj mase, duke deklaruar: “s’ngre karton që t’i hiqet imuniteti²⁰”

Në këtë kontekst, hetimi ndaj Ballukut u kthye nga një çështje juridike në një krizë të hapur politike dhe institucionale, ku u përfshinë:

- ekzekutivi (qeveria)
- legjislativi (Kuvendi)
- sistemi i drejtësisë (SPAK dhe Gjykata Kushtetuese)

ii. Rasti Ahmetaj, Veliaj, Meta, etj.

Përveç rastit Balluku, periudha karakterizohet nga një seri çështjesh dhe hetimesh që përfshijnë figura të rëndësishme politike, duke krijuar një klimë të përgjithshme presioni dhe polarizimi.

[gijkatat-te-pezulloje-ministrat-dhe-postet-kushtetues](#)

¹⁸ <https://tvklan.al/pezullimi-i-ballukut-rama-nje-budallallek-boteror>

¹⁹ <https://www.reporter.al/2026/02/09/ndryshime-ligjore-rama-shpall-kabinetin-e-tij-te-paprekshem-nga-masat-e-spak/>

²⁰ <https://www.tpz.al/aktualitet/sngre-karton-ge-ti-hiqet-imuniteti-rama-per-ballukun-do-te-kete-ne-kr-i315139>

A. Ahmetaj shfaqet si një figurë kyçe në diskursin opozitar, përmes intervistave dhe deklaratave publike ku ai artikulon akuza të drejtpërdrejta ndaj qeverisë. Në një intervistë të publikuar në janar, ai akuzon kryeministrin si: “*kreu i organizatës*.”²¹ Deklaratat e tij përdoren nga opozita për të legjitimuar narrativën e korrupsionit në nivelet më të larta të qeverisë.

I. Meta mbështet publikisht Ahmetajn dhe e pozicionon atë si figurë opozitare, duke e cilësuar: “...një luftëtar për të ardhmen e Shqipërisë”²²... Roli i Metës në këtë kontekst është kryesisht politik dhe narrativ, duke kontribuar në rritjen e tensionit dhe polarizimit.

Edhe pse nuk shfaqen me të njëjtën intensitet si Balluku apo Ahmetaj, figura të tjera si E. Veliaj përmenden në diskursin publik dhe mediatic si pjesë e një klime më të gjerë hetimesh dhe dyshimesh ndaj zyrtarëve të lartë.

iii. Roli i SPAK dhe vendimet gjyqësore

SPAK dhe institucionet e drejtësisë luajnë një rol qendror në këtë periudhë, duke qenë njëkohësisht aktorë juridikë dhe objekt i diskursit politik.

Aktiviteti institucional

- SPAK ndërmerr hetime ndaj zyrtarëve të lartë.
- Gjykata Kushtetuese merr vendime me impakt të drejtpërdrejtë politik (si në rastin Balluku)

Këto veprime shënojnë një fazë aktive të drejtësisë në raport me korrupsionin dhe përgjegjshmërinë politike.

Reagimi politik ndaj SPAK

Roli i SPAK interpretohet në mënyrë diametralisht të kundërt:

- **Qeveria:** e kritikon si të tejkaluar kompetencat dhe të papërgjegjshëm
- **Opozita:** e mbështet kur godet qeverinë, por e delegitimim kur prek interesat e saj

Deklarata si: “*De facto SPAK nuk ekziston më*”²³ tregojnë nivelin e delegitimimit politik ndaj institucionit.

Vendimet gjyqësore si faktor tensioni

Vendimet e drejtësisë, veçanërisht:

- pezullimi nga detyra;
- kërkesat për arrest;
- kërkesat për heqje imuniteti,

janë kthyer në katalizatorë të konfliktit politik.

Vendimet nuk perceptohen si teknike/juridike, por si akte me implikim politik të drejtpërdrejtë

²¹ <https://lapsi.al/2026/01/09/intervista-skandalet-e-reja-te-korrupsionit-qe-denoncoi-arben-ahmetaj/>

²² <https://lapsi.al/2026/01/09/intervista-skandalet-e-reja-te-korrupsionit-qe-denoncoi-arben-ahmetaj/>

²³ <https://kohajone.com/lajme/sali-berisha-de-facto-spak-nuk-ekziston-me-protestat-rruga-e-vetme/>

III. MARRËDHËNIA POLITIKË – DREJTËSI

i. Ndryshime ligjore

Gjatë periudhës janar–mars 2026, marrëdhënia midis politikës dhe drejtësisë karakterizohet nga tentativa të qarta për ndërhyrje në kuadrin ligjor, kryesisht si reagim ndaj veprimeve të institucioneve të drejtësisë ndaj zyrtarëve të lartë.

Pika kulmore e këtij procesi lidhet me reagimin e qeverisë ndaj vendimit për pezullimin nga detyra të B. Ballukut. Ky vendim shërbeu si katalizator për artikullimin e nevojës për ndryshime ligjore, me qëllim kufizimin e efekteve të masave të drejtësisë mbi funksionet ekzekutive. Kryeministri Edi Rama deklaroi se: *“Funksionet e padelegueshme kushtetuese... nuk mund të pezullohen kurrësesi nga askush²⁴...”*

Në këtë linjë, u artikulua nevoja për ndryshime në Kodin Penal dhe kuadrin procedural, duke synuar të kufizohet mundësia e pezullimit nga detyra për funksionarët e lartë publikë.

Ky zhvillim tregon një zhvendosje nga reagimi politik në drejtim të instrumentalizimit të legjislacionit, për të krijuar barriera ndaj veprimeve të drejtësisë. Ndryshimet ligjore nuk paraqiten si reforma strukturore, por si reagime të drejtpërdrejta ndaj rasteve konkrete hetimore.

ii. Retorika për “ndarjen e pushteteve”

Diskursi politik gjatë kësaj periudhe përdor në mënyrë të vazhdueshme konceptin e “ndarjes së pushteteve”, por në funksion të justifikimit të qëndrimeve politike dhe jo si parim institucional i qëndrueshëm.

Qeveria argumenton se veprimet e drejtësisë përbëjnë tejkalim kompetencash dhe ndërhyrje në funksionet e ekzekutivit. Në këtë kontekst, vendimet e drejtësisë interpretohen si cenim i rendit kushtetues dhe i balancës së pushteteve. Kryeministri e cilëson ndërhyrjen e drejtësisë si: *“një budallallëk botëror²⁵”* dhe paralelisht mbron parimin që funksionet ekzekutive nuk mund të preken nga vendime gjyqësore.

Nga ana tjetër, opozita përdor të njëjtin koncept për të akuzuar qeverinë për kontroll mbi drejtësinë dhe për shkelje të pavarësisë së saj. Deklarata si: *“De facto SPAK nuk ekziston më²⁶”* reflektojnë perceptimin e opozitës për një sistem drejtësie të kapur politikisht.

Diskursi politik është selektiv dhe oportunist, Nuk ka një konsensus mbi kufijtë institucionalë dhe “Ndarja e pushteteve” përdoret si instrument retorik nga të dyja palët

iii. Konflikt institucional

Periudha karakterizohet nga një përshkallëzim i qartë i konfliktit ndërmjet institucioneve, duke përfshirë qeverinë, Kuvendin dhe gjyqësorin (SPAK dhe Gjykata Kushtetuese).

Rasti Balluku shërben si pika qendrore e këtij konflikti, ku vendimet e drejtësisë përballen me rezistencë politike dhe institucionale. Refuzimi për heqjen e imunitetit dhe qëndrimet publike të qeverisë krijojnë një situatë ku:

²⁴ <https://www.reporter.al/2026/02/09/ndryshime-ligjore-rama-shpall-kabinetin-e-tij-te-paprekshem-nga-masat-e-spak/>

²⁵ <https://tvklan.al/pezullimi-i-ballukut-rama-nje-budallallek-boteror>

²⁶ <https://kohajone.com/lajme/sali-berisha-de-facto-spak-nuk-ekziston-me-protestat-rruga-e-vetme/>

- vendimet gjyqësore kontestohen hapur
- legjislativi përdoret për të bllokuar procedura juridike
- ekzekutivi ndërhyt përmes diskursit dhe iniciativave ligjore

Deklarata e kryeministrit “s’ngre karton që t’i hiqet imuniteti²⁷” përfaqëson një ndërhyrje direkte politike në proceset që lidhen me drejtësinë.

Në të njëjtën kohë, drejtësia, përmes SPAK dhe Gjykatës Kushtetuese, vijon të ndërmarrë veprime me impakt të lartë politik, duke thelluar përplasjen ndërinstitucionale.

IV. ROLI I FAKTORËVE NDËRKOMBËTARË

i. BE, SHBA, ambasadat

Gjatë periudhës janar–mars 2026, faktorët ndërkombëtarë, veçanërisht Bashkimi Europian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës²⁸ dhe përfaqësitë diplomatike në Tiranë, luajnë një rol të rëndësishëm në diskursin mbi drejtësinë dhe luftën kundër korrupsionit.

Ndryshe nga aktorët politikë vendas, qëndrimet e tyre karakterizohen nga një linjë relativisht konsistente në mbështetje të institucioneve të drejtësisë dhe reformës në drejtësi²⁹.

Në reagimet publike, theksi vihet në:

- pavarësinë e institucioneve të drejtësisë;
- vazhdimin e hetimeve ndaj korrupsionit në nivele të larta;
- domosdoshmërinë e respektimit të vendimeve gjyqësore.

Ambasadat dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë shmangin përfshirjen direkte në konfliktin politik, por ndërhyjnë në mënyrë të tërthortë përmes deklaratave që mbështesin funksionimin e drejtësisë³⁰.

ii. Qëndrimet ndaj SPAK dhe korrupsionit

Në të gjitha rastet e evidentuara gjatë monitorimit, faktorët ndërkombëtarë mbajnë një qëndrim të qartë në mbështetje të SPAK dhe luftës kundër korrupsionit.

SPAK konsiderohet një institucion kyç i reformës në drejtësi si dhe një mekanizëm për luftën kundër korrupsionit në nivele të larta.

Ndërkombëtarët theksojnë nevojën që:

- hetimet të zhvillohen pa ndërhyrje politike;
- vendimet e drejtësisë të respektohen;
- proceset të jenë transparente dhe të bazuara në ligj.

²⁷<https://www.tpz.al/aktualitet/sngre-karton-qe-ti-hiqet-imuniteti-rama-per-ballukun-do-te-kete-ne-kr-i315139>

²⁸<https://sot.com.al/politike/e-ngarkuara-me-pune-e-shba-ve-takim-koke-me-koke-me-kryetaren-e-gjykates-kushtetuese-ja-fokusi-i-diskutimeve/>

²⁹<https://www.gazetatema.net/politika/komisioni-europian-reagon-per-nderhyrjen-e-rames-ne-kodin-e-procedures-i544642>

³⁰<https://www.gazetatema.net/politika/komisioni-europian-reagon-per-nderhyrjen-e-rames-ne-kodin-e-procedures-i544642>

iii. Ndikimi në integrim

Roli i faktorëve ndërkombëtarë lidhet drejtpërdrejt me procesin e integritit evropian të Shqipërisë dhe çdo tension politik–drejtësi ka impakt negativ në procesin e integritit. Reforma në drejtësi dhe funksionimi i SPAK janë elementë kyç në vlerësimin e progresit të vendit drejt Bashkimit Evropian³¹. Në këtë kuadër, performanca e institucioneve të drejtësisë ndikon në raportet e progresit³²; lufta kundër korrupsionit është kusht për avancimin e negociatave; stabiliteti institucional është faktor thelbësor për besueshmërinë ndërkombëtare.

Përplasjet politike me drejtësinë, si në rastin Balluku, krijojnë perceptim negativ për pavarësinë e institucioneve dhe respektimin e shtetit të së drejtës

V. KLIMA POLITIKE DHE DISKURSI PUBLIK

i. Gjuha

Gjatë periudhës janar–mars 2026, diskursi publik në Shqipëri karakterizohet nga një përshkallëzim i dukshëm i gjuhës politike, e cila kalon nga debat institucional në një komunikim të fortë, emocional dhe shpesh denigrues.

Aktorët politikë përdorin një gjuhë që:

- delegitimon kundërshtarin
- sulmon institucionet
- redukton debatin në narrativa konfliktuale

Nga ana e qeverisë, kryeministri përdor formulime ironike dhe denigruese ndaj drejtësisë dhe opozitës, si: “*stacioni i fundit i rrugës së shpresës*³³” dhe: “*fletët e arrestit plotësohen lehtësisht si ftesa dasmash.*” Në të njëjtën linjë, vendimet e drejtësisë cilësohen si: “*një budallallëk botëror*”³⁴

Nga ana tjetër, opozita përdor një gjuhë edhe më të ashpër dhe delegitimuese ndaj institucioneve të drejtësisë dhe qeverisë, me deklarata si: “*SPAK-u është zero me bisht, se drejtësia nuk ekziston*³⁵” dhe: “*De facto SPAK nuk ekziston më*³⁶”

Kjo gjuhë shoqërohet shpesh me:

- etiketime personale;
- tone populiste;

³¹https://dritare.net/ngjarjet-e-dites/pe-zbardh-305-amendamente-per-shqiperine-mbeshtetje-per-spak-jo-i786983?fbclid=IwY2xjawQtCEVleHRuA2FlbQlxMABicmlkETFoOGZsbTVDRjlQYmdZeXFXc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHqQAesdyS64AQhH350_swciEDm46lPvq1oM_NEG6qJTUXNcaiXOjyUj-MLMn_aem_mUsbuwylVNYl2wetu2R3bA

³²<https://shqiptarja.com/lajm/ska-kohe-per-te-humbur-ambasadori-i-be-ne-shqiperi-dosjet-neper-gjykata-jane-stok-te-shtohet-numri-i-gjyqtareve-e-prokuroreve-si-dhe-i-asistenteve-te-tyre-ligjore>

³³ <https://www.kryeministria.al/newsroom/parlament-fjala-e-kryeministrit-edi-rama-2/>

³⁴ <https://tvklan.al/pezullimi-i-ballukut-rama-nje-budallallek-boteror>

³⁵ <https://www.gazetatema.net/politika/lubia-e-paprekshme-spak-u-zero-me-bisht-berisha-fjalimi-i-rames-elegji-i548268>

³⁶ <https://kohajone.com/lajme/sali-berisha-de-facto-spak-nuk-ekziston-me-protestat-rruga-e-vetme/>

- thjeshtim të çështjeve komplekse në narrativa bardhë e zi.

ii. Protestat dhe dhuna

Klima politike gjatë kësaj periudhe reflektohet edhe në zhvillimin e protestave të opozitës, të cilat në disa raste karakterizohen nga tension dhe përdorim i mjeteve të dhunshme. Protestat shfaqen si një instrument politik për të ushtruar presion ndaj qeverisë dhe institucioneve të drejtësisë, duke u lidhur drejtpërdrejt me zhvillimet hetimore dhe vendimet gjyqësore. Në mars, retorika opozitare e lidh protestën me nevojën për reagim politik dhe institucional, duke e cilësuar atë si: “*rruga e vetme*³⁷.” Në disa raste, protestat shoqërohen me incidente të dhunshme, duke përfshirë përdorimin e mjeteve si molotovë, çka kontribuon në rritjen e tensionit publik dhe përshkallëzimin e konfliktit politik.

iii. Polarizimi politik

Periudha janar–mars 2026 karakterizohet nga një nivel i lartë polarizimi politik, ku ndarja mes qeverisë dhe opozitës thellohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ky polarizim shfaqet në qëndrime diametralisht të kundërta për drejtësinë, mungesë totale konsensusi institucional dhe delegitimim të ndërsjellë.

Qeveria dhe opozita nuk ndajnë asnjë bazë të përbashkët interpretimi për rolin e SPAK, vendimet e drejtësisë apo ndarjen, balancën dhe kufijtë e pushteteve. Ndërsa qeveria i konsideron veprimet e drejtësisë si tejkalim kompetencash, opozita i interpreton ato si të kontrolluara politikisht.

Diskursi i të dyja palëve përjashton kompromisin, forcon ndarjen “ne VS ata” dhe ndikon duke rritur tensionin publik dhe institucional duke krijuar një klimë të qëndrueshme konflikti.

VI. DOMINIMI MEDIATIK I EDI RAMËS DHE SALI BERISHËS³⁸

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, diskursi publik dhe hapësira mediatike në Shqipëri paraqiten të dominuara në mënyrë të theksuar nga dy figura kryesore politike: E. Rama dhe S. Berisha. Ky dominim shfaqet si një strukturë pothuajse binare e komunikimit publik, ku vëmendja mediatike dhe narrativa politike përqendrohen kryesisht rreth këtyre dy aktorëve, duke kufizuar ndjeshëm hapësirën për zëra alternativë dhe për debat programor. Në këtë kontekst, Rama shfaqet si dominues në aspektin e volumit dhe kontrollit të narrativës, ndërsa Berisha karakterizohet nga një dominim i bazuar në intensitetin konfliktual dhe mobilizimin retorik. Si rezultat, diskursi publik mbetet i polarizuar dhe i personalizuar.

Analiza e këtij dominimi është mbështetur në një monitorim të gjerë të mediave online, televizioneve dhe rrjeteve sociale, duke u bazuar në kodimin e përmbajtjes sipas frekuencës së përmendjes, tonalitetit të komunikimit dhe tipologjisë së mesazheve. Për

³⁷ <https://kohajone.com/lajme/sali-berisha-de-facto-spak-nuk-ekziston-me-protestat-rruga-e-vetme/>

³⁸ Aneks A: Diskursi politik dhe publik në Shqipëri: janar- mars 2026

të matur këtë fenomen është përdorur një indeks sintetik (0–100), i cili reflekton nivelin e dominimit mediatic për secilin aktor. Analiza bazohet në: Monitorim të mediave online, TV dhe rrjete sociale; Kodim të përmbajtjes (sipas frekuencës së përmendjes; tonit (pozitiv / neutral / negativ); tipologjisë së mesazhit (qeverisës / opozitar / konfliktual)) dhe Indeksi sintetik (0–100) për dominim mediatic.

i. Indeksi për dominim mediatic

Muaji	Edi Rama	Sali Berisha
Janar 2026	78	72
Shkurt 2026	82	76
Mars 2026	85	80

Tabela 2_Indeksi i dominimit mediatic (IDM)

Të dhënat tregojnë një rritje graduale të dominimit për të dy figurat përgjatë periudhës janar–mars 2026. E. Rama kalon nga një indeks 78 në janar në 85 në mars, ndërsa S. Berisha nga 72 në 80. Ky trend dëshmon një intensifikim të vazhdueshëm të prezencës dhe ndikimit të tyre në diskursin publik, duke ruajtur një avantazh konstant të Ramës prej rreth 5–6 pikësh. Megjithatë, ndonëse Berisha ndjek nga afër në nivel intensiteti, ai nuk arrin të ushtrojë të njëjtin nivel kontrolli institucional mbi narrativën.

Në aspektin e **shpërndarjes së diskursit**, komunikimi i E. Rama dominohet nga një përqindje e lartë e mesazheve institucionale, të lidhura me qeverisjen, projektet dhe dimensionin ndërkombëtar (45%), ndërsa një pjesë e konsiderueshme përbëhet nga reagime ndaj opozitës (30%) dhe ndërtimi i narrativës politike/propagandë (25%). Në të kundërt, diskursi i S. Berisha është kryesisht i orientuar drejt sulmit ndaj qeverisë (60%) dhe mobilizimit politik (25%), ndërsa hapësira për alternativë programore mbetet e kufizuar (15%). Kjo ndarje tregon një diferencë të qartë midis një komunikimi që synon kontrollin e agjendës dhe një komunikimi që synon përshkallëzimin e konfliktit.

Analiza e tonit përforcon këtë dallim. Diskursi i Ramës paraqet një balancë më të qëndrueshme midis elementeve pozitive (40%), neutral (35%) dhe negativ (25%), duke ruajtur një formë të caktuar institucionaliteti në komunikim. Ndërsa diskursi i Berishës dominohet nga tonaliteti negativ (50%), duke reflektuar një qasje më të ashpër, konfrontuese dhe konfliktuale ndaj kundërshtarëve politikë dhe institucioneve.

Aktori	Pozitiv	Neutral	Negativ
E. Rama	40%	35%	25%
S. Berisha	20%	30%	50%

Tabela 3_Analiza e tonit

ii. Dominimi sipas Platformave

Dominimi mediatik i dy aktorëve shfaqet gjithashtu në mënyra të ndryshme në varësi të platformës.

- **Në televizionet tradicionale**, Rama dominon përmes aktivitetit qeveritar dhe komunikimit të strukturuar/ podcasteve të tij, ndërsa Berisha përmes deklaratave dhe konferencave për shtyp.
- **Në mediat online**, rivaliteti është më i balancuar, por titujt e orientuar nga konflikti priren të favorizojnë Berishën.
- **Në rrjetet sociale**, Rama përdor një narrativë të kurrar dhe vizuale, shpesh me elemente propagandistike shpesh here edhe agresive ndaj mediave tradicionale e online, ndërsa Berisha mbështetet në volum të lartë komunikimi, reagim të menjëhershëm dhe mobilizim të audiencës.

iii. Indeksi i Polarizimit

Një element thelbësor i kësaj dinamike është rritja e vazhdueshme e polarizimit. Indeksi i polarizimit rritet nga 68 në janar në 79 në mars, duke reflektuar një kalim gradual nga një diskurs kritik në një konfrontim gjithnjë e më personal dhe të ashpër. Ky trend tregon se dominimi mediatik nuk është i shkëputur nga klima politike, por është i lidhur ngushtë me përshkallëzimin e konfliktit.

Muaji	Indeksi (0–100)
Janar 2026	68
Shkurt 2026	74
Mars 2026	79

Tabela 4_Indeksi i Polarizimit

Në këtë kuadër, disa gjetje kryesore bëhen të dukshme:

- **Duel i mbyllur politik:** Diskursi publik funksionon si një duel i mbyllur midis dy figurave kryesore, ku hapësira për aktorë të tjerë mbetet minimale.
- **Asimetri në pushtet vs zë:** Ekziston një asimetri e qartë midis pushtetit dhe zërit, ku Rama kontrollon agjendën dhe strukturën e komunikimit, ndërsa Berisha dominon përmes intensitetit dhe zhurmës politike.
- **Media:** vepron si amplifikator i këtij konflikti, duke favorizuar përmbajtje që gjeneron më shumë vëmendje dhe ndërveprim, konflikti personal prodhon më shumë klikime dhe mbulim
- **Dobësim i debatit programor:** debati politik dobësohet në dimensionin programor dhe reduktohet në një përballje të vazhdueshme personale. Politika reduktohet në narrativë përballjeje

Parashikimet për tremujorin e dytë të vitit 2026 sugjerojnë një vazhdim të këtij trendi, me rritje të mëtejshme të polarizimit dhe intensifikim të sulmeve personale. Në të njëjtën kohë, ekziston rreziku i një *“lodhjeje publike”* nga përsëritja e të njëjtit diskurs konfliktual.

Në përfundim, dominimi mediatik i Edi Ramës dhe Sali Berishës nuk përbën thjesht një fenomen të prezencës së lartë mediatike, por reflekton një strukturë më të thellë të sistemit politik dhe mediatik në Shqipëri. Ky dominim kontribuon në ngushtimin e pluralizmit, rritjen e polarizimit dhe zhvendosjen e debatit nga politika drejt personave.

Tendenca e përgjithshme tregon një rritje progresive të dominimit për të dy aktorët, me një avantazh të qëndrueshëm të Ramës, ndërsa polarizimi shfaq një rritje lineare që arrin kulmin në muajin mars. Në këtë kontekst, Rama konsolidon një profil më institucional dhe të orientuar drejt kontrollit të narrativës, ndërsa Berisha mbetet një aktor thellësisht konfliktual, agresiv dhe mobilizues në diskursin publik.

VII. GJETJE DHE REKOMANDIME

Monitorimi i periudhës janar -mars 2025 tregon se:

i. Gjetje kryesore

- I. **Politizim i theksuar i drejtësisë:** Drejtësia dhe SPAK janë përdorur në mënyrë të vazhdueshme si instrument në diskursin politik, si nga qeveria ashtu edhe nga opozita.
 - Qeveria kalon nga mbështetje deklarative në kritikë dhe delegitimim;
 - Opozita përdor SPAK në mënyrë selektive, sipas interesit politik;
 - Drejtësia nuk trajtohet si institucion neutral, por si element i betejës politike.
- II. **Rasti Balluku si epiqendër e konfliktit:** Çështja e B. Ballukut përbën pikën më të fortë të përplasjes, rasti shndërrohet nga hetim penal në krizë politike:
 - aktivizon reagime politike të forta;
 - shkakton tension ndërinstitucional;
 - përdoret si argument për ndërhyrje ligjore.
- III. **Ndërhyrje politike në drejtësi:** Janë evidentuar tentativa të drejtpërdrejta për:
 - ndryshime ligjore që kufizojnë veprimet e drejtësisë
 - mbrojtje politike të zyrtarëve të hetuar
 - kontestim publik të vendimeve gjyqësore
- IV. **Delegitimim i institucioneve të drejtësisë:** Të dyja palët politike përdorin gjuhë që minon besimin te drejtësia dhe kontribuon në erozionin e besimit publik:
 - *“SPAK nuk ekziston më”;*
 - *“fletë arresti si ftesa dasmash”;*
 - *“budallallëk botëror”.*
- V. **Rritje e agresivitetit në diskursin publik:** Debatu largohet nga standardet institucionale ndërsa diskursi politik karakterizohet nga:
 - gjuhë denigruese;

- tone populiste;
- sulme personale.

VI. Përshkallëzim i konfliktit dhe polarizimit: Polarizimi është i thellë dhe strukturor, ka mungesë totale konsensusi, qëndrime diametralisht të kundërta dhe rritje e tensionit politik dhe publik.

VII. Faktorët ndërkombëtarë si element stabilizues mbajnë një linjë konsistente pro drejtësisë:

- mbështetje e qartë për SPAK;
- fokus te lufta kundër korrupsionit;
- lidhje direkte me procesin e integritimit.

ii. Rekomandime

I. Respektim i pavarësisë së drejtësisë: Aktorët politikë duhet të shmangin ndërhyrjet direkte dhe indirekte në proceset gjyqësore dhe të respektojnë vendimet e institucioneve të drejtësisë.

II. Depolitizim i diskursit për drejtësinë: Drejtësia nuk duhet të përdoret si instrument politik. Diskursi publik duhet të fokusohet në standarde ligjore dhe jo në narrativa politike.

III. Përmirësim i komunikimit publik

- shmangie e gjuhës denigruese;
- respektim i etikës institucionale;
- rritje e përgjegjshmërisë në deklarata publike.

IV. Transparencë dhe profesionalizëm nga institucionet e drejtësisë: SPAK dhe institucionet e tjera duhet të:

- komunikojnë qartë dhe në mënyrë profesionale;
- rrisin transparencën për të forcuar besimin publik.

V. Forcim i balancës së pushteteve: Institucionet duhet të funksionojnë në respekt të ndarjes së pushteteve, duke shmangur përplasjet dhe duke garantuar bashkëpunim institucional.

VI. Reduktim i tensionit politik: Aktorët politikë duhet të shmangin përshkallëzimin e konfliktit dhe të promovojnë dialog institucional.

VII. Vazhdim i mbështetjes ndërkombëtare: Mbështetja e BE dhe SHBA për reformën në drejtësi duhet të vazhdojë, duke ndihmuar në konsolidimin e institucioneve dhe procesit të integritimit.

ANEKS A: DISKURSI POLITIK DHE PUBLIK NË SHQIPËRI: JANAR- MARS 2026

Në **janar 2026**, diskursi politik dhe publik në Shqipëri u karakterizua nga tensione të forta opozitë– qeveri, akuzat e ish-zv/kryeministrit në arrati për korrupsionin e qeverisë dhe të vetë kryeministrit, protesta dhe ndikimi i krizave sociale (përmbytjet, në mbarë vendin). Në më

a. Protesta e opozitës dhe përshkallëzimi i tensioneve

Partia Demokratike e Shqipërisë organizoi një **protestë kombëtare në Tiranë** më 24 janar. Kjo ishte ngjarja më e rëndë politike e muajit dhe sinjal i një klime të tensionuar. Pasi përplasjet në Kuvendin e Shqipërisë në çelje të sesionit të ri parlamentar.

Kërkesa kryesore lidhej me:

- dorëheqjen e qeverisë së Edi Rama
- akuzat për korrupsion dhe krizë politike.

Protesta degjeneroi në përplasje me policinë:

- u përdorën **molotovë ndaj forcave të rendit**
- u plagosën 11 policë
- dhjetëra persona u arrestuan ose proceduan penalisht

b. Retorikë krize

Opozita e drejtuar nga Sali Berisha ka nisur një fazë presioni të vazhdueshëm ndaj qeverisë dhe e paraqiti gjatë gjithë muajit janar situatën si:

- **krizë politike dhe morale të qeverisë, duke u fokusuar në rastin Balluku dhe akuzat e ish- zv/kryeministrit A. Ahmetaj për korrupsionin e qeverisë.**

U paralajmërua se protestat:

- nuk do të ishin episodike, por **proces i vazhdueshëm**

c. Përplasje politike rreth korrupsionit dhe drejtësisë

Klima politike mbeti e polarizuar dhe konfliktuale. Diskursi politik i muajit dominohej nga:

- akuza për korrupsion ndaj qeverisë
- kundërukuza për instrumentalizim politik të drejtësisë
- Çështjet e korrupsionit (të trashëguara nga 2025) mbetën në qendër të debatit publik dhe politik

d. 21 Janari si simbol politik dhe përplasje narrativash

Përvjetori i Protestës së 21 janarit 2011 u rikthye në debat:

- si simbol i ndarjes politike
- si “test moral” për politikën shqiptare duke dëshmuar se ngjarjet historike vazhdojnë të përdoren si armë politike aktuale.

e. Kriza e përmbytjeve dhe ndikimi politik (6–12 janar)

Kriza natyrore në fillim të janarit u shndërrua edhe në çështje politike. Shqipëria u godit nga **përmbytje të mëdha**:

- zona të prekura: Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër etj.
- evakuime masive dhe dëme ekonomike

Pasojat:


- kritika ndaj menaxhimit të situatës nga qeveria
- rritje e pakënaqësisë publike

f. Sistemi i drejtësisë, mbështetja dhe sulmet


Forcat kryesore politike shqiptare kanë vazhduar me qëndrimin e tyre, përgjithësisht kundër drejtësisë, ndërkohë që ndërkombëtarët e kanë shprehur hapur dhe pa ekuivoke mbështetjen ndaj Drejtësisë së Re.


- PS del kundër SPAK dhe drejtësisë duke mbrojtur me çdo kusht Ballukun.
- PD qëndrime ambiguiqe, duke e sulmuar kur vjen puna tek Berisha dhe mbështetur sa herë goditet qeveria.
- SPAK heton korrupsionin në nivele të larta të politikës.

Krahasim i Diskursit Politik: Mazhorancë vs Opozitë (Janar 2026)



Timeline i Diskursit Politik - Janar 2026





RAPORT SINTETIK PËR MUAJIN SHKURT 2026

1. Përmbledhje

Gjatë muajit shkurt 2026, Shqipëria përjetoi një intensifikim të ndjeshëm të tensioneve ndër-institucionale, të lidhura kryesisht me ndërveprimin midis ekzekutivit, legjislativit dhe sistemit të drejtësisë. Në qendër të zhvillimeve ishte çështja e pezullimit dhe më pas shkarkimit të zëvendëskryeministres Belinda Balluku, e hetuar për korrupsion në tendera publikë. Mbrojtja, “lëshimi” dhe përsëri mbrojtja e Ballukut duke u sulmuar Drejtësia, ishin epiqendra e zhvillimeve politike në Shqipëri. Protestat e dhunshme të opozitës, por edhe reagimi isproporcional i policisë gjithashtu kanë ndikuar në polarizimin e klimës së tensionuar politike. Gjuha e përdorur në Kuvend ka qenë tej limiteve të lejuara të etikës.

Reagimi ndërkombëtar në mbështetje të Drejtësisë, duket se ka nxjerrë në pah “aleancën” mes forcave politike në Shqipëri.

Ngjarjet e muajit evidentuan:

- sfida në balancën e pushteteve,
- presione të perceptuara ndaj sistemit të drejtësisë,
- polarizim të lartë politik,
- protesta dhe reagime
- shqetësime të vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë lidhur me sundimin e ligjit.

2. Zhvillimet Kryesore Institucionale

2.1 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese

- Gjykata Kushtetuese la në fuqi vendimin për pezullimin e zv/kryeministres, pas një votimi të barabartë (4–4).
- Mosvendimmarrja përfundimtare krijoi pasiguri juridike mbi kompetencat për pezullimin e anëtarëve të qeverisë.
- Rasti ekspozoi vakuume ligjore dhe interpretime të ndryshme mbi ndarjen e pushteteve.

2.2 Reagimi i Ekzekutivit

- Kryeministri kundërshtoi publikisht vendimin, duke e cilësuar precedent të rrezikshëm.

- U paralajmëruan ndryshime ligjore për të kufizuar mundësinë e pezullimit të funksionarëve të lartë nga gjykatat.
- U shty shqyrtimi parlamentar i kërkesës për arrestimin e Ballukut.

2.3 Nisma Ligjore

- Propozime për ndryshime në Kodin e Procedurës Penale:
 - përjashtim i zyrtarëve të lartë (përfshirë kryeministrin dhe ministrat) nga masa e pezullimit.
- Nisma u kritikua nga aktorë vendas dhe ndërkombëtarë për rrezik ndaj pavarësisë së drejtësisë.

3. Roli i Sistemit të Drejtësisë

- SPAK vijoi hetimet dhe kërkoi masa të ashpra, përfshirë arrestimin e Ballukut dhe dënime në raste të tjera korrupsioni (p.sh. “Dosja 5D”).
- Sistemi i drejtësisë u përball me:
 - kritika të forta publike nga ekzekutivi,
 - akuza politike nga opozita.
- Diskursi publik kontribuoi në uljen e besimit institucional dhe perceptimit të pavarësisë së sistemit të drejtësisë nga politika.

4. Reagimi Ndërkombëtar

4.1 Bashkimi European

- Theksoi nevojën për:
 - trajtim pa vonesë të kërkesave për heqje imuniteti,
 - respektim të standardeve të sundimit të ligjit.
- Shprehu shqetësim për:
 - presionet ndaj gjyqësorit,
 - retorikën që minon besimin publik.
- Konfirmoi se progresi drejt anëtarësimit lidhet drejtpërdrejt me:
 - luftën kundër korrupsionit,
 - funksionimin e drejtësisë.

4.2 Shtetet e Bashkuara dhe partnerë të tjerë

- Riafirmuan mbështetjen për:
 - reformën në drejtësi,
 - forcimin e institucioneve të zbatimit të ligjit.
- Theksuan rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe luftës kundër krimit të organizuar.

5. Dinamika Politike dhe Sociale

5.1 Polarizimi Politik

- Retorikë e ashpër mes mazhorancës dhe opozitës.
- Tensione të vazhdueshme në Kuvend, me incidente verbale dhe procedurale.

5.2 Protestat

- Protesta të përsëritura të opozitës në Tiranë, disa prej të cilave të dhunshme.
- Përplasje me policinë, arrestime dhe dëmtime.
- Dënim i dhunës nga përfaqësitë ndërkombëtare.

5.3 Shoqëria Civile

- Kërkoj shqyrtim të menjëhershëm të kërkesave të SPAK.
- Paralajmëroi rrezikun e impunitetit në rast vonesash.

6. Ndryshimet në Ekzekutiv

- Shkarkimi i Belinda Ballukut dhe riformatimi i kabinetit qeveritar.
- 7 ndryshime në qeveri, përfshirë poste kyçe.
- Lëvizjet u interpretuan si:
 - reagim ndaj presionit të brendshëm dhe ndërkombëtar,
 - përpjekje për stabilizim politik.

7. Integrimi European

- Progres i konsiderueshëm teknik:
 - hapja e kapitujve negociues në kohë rekord.
- Sfida kryesore:
 - sundimi i ligjit,
 - lufta kundër korrupsionit në nivele të larta,
 - polarizimi politik.
- Institucionet e BE-së kërkuar:
 - dialog politik,
 - zbatim të qëndrueshëm të reformave.

8. Vlerësim i rreziqeve




Fusha	Rreziku
Sundimi i ligjit	Ndërhyrje potenciale në pavarësinë e gjyqësorit
Stabiliteti politik	Rritje e polarizimit dhe protestave
Reforma në drejtësi	Ngadalësim ose devijim nga standardet
Integrimi në BE	Kushtëzim i progresit nga performanca në sundimin e ligjit

9. Përfundime

Muaji shkurt 2026 evidenton një fazë kritike për konsolidimin institucional në Shqipëri. Ndërsa progresi në integrimin europian mbetet i dukshëm, tensionet midis pushteteve dhe retorika politike rrezikojnë të minojnë arritjet në reformën në drejtësi.

10. Rekomandime

- **Mbështetje për sundimin e ligjit**
Forcimi i kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë dhe garantimi i pavarësisë së tyre.
- **Nxitje e dialogut politik**
Mbështetje për platforma ndërpartiake dhe procese të ndërmjetësimi.
- **Monitorim i reformave ligjore**
Vlerësim i përputhshmërisë së nismave me standardet e BE-së.
- **Angazhim me shoqërinë civile**
Mbështetje për aktorët që promovojnë transparencën dhe llogaridhënien.



Diskursi politik – Pozitë vs Opozitë (Shkurt 2026)

Elementi i diskutit	Pozita (Qeveria / PS)	Opozita (PD dhe aleatët)
Narrativa kryesore	Mbrojtja e sovranitetit të ekzekutivit; “balancë pushtetesh”	Denoncim i “kapjes së shtetit” dhe korrupsionit sistemik
Qëndrimi ndaj drejtësisë (SPAK/GJKKO)	Mbështetje formale, por kritika për “teprim” dhe ndërhyrje në ekzekutiv	Mbështetje selektive; përdorim i hetimeve si prova kundër qeverisë
Rasti Balluku	Minimizohet si çështje individuale; kundërshtohet pezullimi si precedent	Shfrytëzohet si simbol i korrupsionit në nivele të larta
Diskursi ndaj institucioneve	Theksohet pavarësia e pushteteve, por kërkohet kufizim i gjyqësorit	Akuzë për kontroll politik të institucioneve nga qeveria
Retorika publike	Ironike, delegitimuese ndaj gjyqësorit (“precedent i rrezikshëm”)	Agresive, dramatike (“narkoregjim”, “regjim i korruptuar”)
Qasja ndaj reformave ligjore	Proaktive për ndryshime që kufizojnë pezullimin e zyrtarëve	Kundërshtuese; i konsideron si tentativa për imunitet politik
Qëndrimi ndaj BE-së	Thekson progresin dhe mbështetjen ndërkombëtare	Argumenton se qeveria po rrezikon integrimin
Protestat	I konsideron destabilizuese dhe të dhunshme	I promovon si mjet legjitim presioni politik

Përdorimi i gjuhës politike	Institucionale në formë, por me tone sarkastike	Populiste, mobilizuese dhe shpesh konfrontuese
Strategjia komunikative	Centralizuar, e unifikuar (mesazhe të koordinuara)	Fragmentuar, por intensive dhe e orientuar drejt krizës
Target audience	Ndërkombëtarët dhe administrata publike	Elektorati i pakënaqur dhe publiku protestues
Qëllimi politik i diskursit	Ruajtja e kontrollit institucional dhe legjitimitetit	Delegjitimimi i qeverisë dhe mobilizimi për ndryshim

Konkluzione:

- Diskursi i **pozitës** është mbrojtës dhe institucional në formë, por me përmbajtje që synon **kufizimin e ndikimit të drejtësisë mbi ekzekutivin**.
- Diskursi i **opozitës** është i ndërtuar mbi krizë dhe delegjitimim, duke përdorur gjuhë **mobilizuese dhe polarizuese**.
- Të dy palët kontribuojnë në një **rritje të polarizimit politik**, duke dobësuar hapësirën për dialog dhe kompromis.
- Narrativat rreth drejtësisë janë thelbësore dhe shpesh **instrumentalizohen politikisht**.

Vlerësimi për muajin shkurt

Metodologjia e indeksit (INDP)

Çdo rubrikë vlerësohet në shkallë **1–5**:

- **Tone (T)**
1 = shumë konfliktual / emocional
5 = racional / i moderuar
- **Agresivitet (A)**
1 = i ulët
5 = shumë i lartë (gjuhë sulmuese, delegjitimuese)
- **Institucionalitet (I)**
1 = populist / jashtë institucioneve
5 = institucional / formal / i bazuar në norma

Aktori	Tone (T)	Agresivitet (A)	Institucionalitet (I)	Indeksi Total (mesatare)
Pozita (PS/Qeveria)	3.5	3.0	4.0	3.5
Opozita (PD & aleatë)	2.0	4.5	2.5	3.0

Interpretimi i Indeksit

Pozita (3.5)

- Diskurs relativisht **institucional në formë**, por me tone shpesh **ironike dhe mbrojtëse**.
- Agresivitet mesatar, i fokusuar kryesisht ndaj sistemit të drejtësisë.

- Strategji: ruajtje legjitimiteti + kontroll narrativ.

Opozita (3.0)

- Diskurs më **emocional dhe konfrontues**.
- Agresivitet i lartë, me gjuhë delegjitimeuse (“regjim”, “korrupsion sistemik”).
- Institucionalitet më i ulët për shkak të fokusit në protesta dhe mobilizim.
- Strategji: **krizë + mobilizim politik**.

Raport sintetik mars 2026

1. Përmbledhje

Periudha mars 2026 karakterizohet nga:


- **Polarizim ekstrem politik** (mazhorancë–opozitë)
- **Delegjitimim reciprok i institucioneve**, sidomos drejtësisë
- **Rritje e gjuhës konfliktuale dhe denigruese**
- **Përplasje e hapur me aktorë ndërkombëtarë**
- **Dobësim i konsensusit për reformat, veçanërisht drejtësinë**

Ngjarja dominuese:

- Rasti “**Balluku**” – pikë kulmore e konfliktit politik, institucional dhe ndërkombëtar.

2. Indeksi sintetik i diskursit (0–100)

Dimensioni	Vlerësimi	Interpretimi
Polarizimi politik	92	Shumë i lartë
Gjuha konfliktuale	88	Dominante
Besimi ndaj drejtësisë	34	I ulët
Mbështetje për reforma	41	E fragmentarizuar
Ndërhyrje politike në drejtësi	85	Shumë e lartë
Stabilitet institucional	38	I brishtë



3. Tabela e ngjarjeve kryesore (Mars 2026)

Data	Ngjarja	Ndikimi
1 mars	Shkarkimi i drejtuesve të Policisë	Politizim i rendit
5 mars	Përplasje fizike në Kuvend	Degjenerim i debatit
9–12 mars	Refuzimi i arrestimit të Ballukut	Krizë drejtësie
13 mars	Reagime ndërkombëtare	Presion ndaj qeverisë
17 mars	Rezoluta për Iranin	Konsensus selektiv
18 mars	Çështje të mëdha në SPAK	Aktivizim drejtësie
22 mars	Protestë e dhunshme	Eskalim në rrugë

4. Analiza e diskursit politik

4.1 Mazhoranca (PS)

Karakteristika kryesore:

- Mbrojtje aktive e figurave të akuzuara
- Diskurs delegitimues ndaj SPAK
- Retorikë ironike dhe shpesh fyese ndaj opozitës
- Vetëpozicionim si garante e reformës

Narrativa dominante:

- “Drejtësia po devijon / është emocionale”
- “Opozita kërkon burg pa prova”
- “PS garanton stabilitetin dhe integritetin”

4.2 Opozita (PD)

Karakteristika kryesore:

- Diskurs akuzues ekstrem (korrupsion sistemik)
- Mbështetje selektive për drejtësinë
- Legjitimim i protestës si mjet politik

Narrativa dominante:

- “Qeveria po mbron korrupsionin”
- “Drejtësia është e kapur ose e goditur”
- “Protesta si rrugë për ndryshim”

5. Qëndrimi ndaj Drejtësisë

Aktorët	Qëndrimi
Mazhoranca	Mbështetje deklarative, kundërshtim praktik në raste konkrete
Opozita	Mbështetje selektive (kur godet qeverinë)
SPAK	Qëndrim institucional mbrojtës
Ndërkombëtarët	Mbështetje e fortë për pavarësinë

6. Gjuha konfliktuale (analizë)


Kategori të identifikuara:

- Fyerje personale


- Denigrim institucional
- Gjuhë seksiste
- Ironi agresive

Intensiteti (0–100):

Aktor	Intensitet
Mazhoranca	82
Opozita	90
Media politike	85



7. Tabela 2 – Trend Mujor (Janar–Mars 2026)



Muaji	Polarizimi	Konflikti	Besimi në drejtësi
Janar	75	70	45
Shkurt	82	78	40
Mars	92	88	34

Trendi:

- Rritje lineare e konfliktit
- Rënie e besimit institucional

8. Tabela 3 – Indeksi i Polarizimit

Faktor	Pesha (%)
Rasti Balluku	35%
Diskursi parlamentar	20%
Protestat	15%

Ndërkombëtarët	15%
Media	15%

9. Ndikimi ndërkombëtar

Aktorë kryesorë:

- BE
- Gjermania
- Britania
- Holanda

Mesazhi i përbashkët:

- Mbështetje për SPAK
- Kundërshtim i ndërhyrjeve politike
- Lidhje direkte me integrimin në BE

- Efekti:

Rritje e presionit ndaj qeverisë + ndërkombëtarizim i krizës

10. Rreziqet Kryesore

- Kapje politike e perceptuar e drejtësisë
- Normalizim i gjuhës së urrejtjes
- Delegitimim i institucioneve
- Radikalizim i protestave
- Ngadalësim i integritit në BE

11. Përfundime

1. Diskursi politik është në nivel kritik polarizimi
2. Drejtësia është kthyer në fushë beteje politike
3. Reformat po përdoren si armë retorike, jo si konsensus
4. Ndërkombëtarët janë faktor stabilizues, por edhe presioni
5. Rrezik real për degradim demokratik gradual

12. Rekomandime

Për politikën:

- Ulje e gjuhës konfliktuale (kode etike funksionale)
- Konsensus minimal për drejtësinë

Për institucionet:

- Transparenca më e lartë në vendimmarrje
- Mbrojtje e pavarësisë së SPAK

Për ndërkombëtarët:


- Presion i balancuar + mbështetje teknike

Indeksi Mesatar i Diskursit (janar- mars 2026)

Muaji	Pozita	Opozita
Janar	3.5	3.1
Shkurt	3.5	3.0
Mars	3.5	3.0

Interpretim:


- Pozita – **e qëndrueshme**, por ndryshim me një cilësor (më agresive)
- Opozita- **pak rënie në tone**, por agresivitet i lartë konstant



Polarizimi

Muaji	Polarizimi
Janar	1.2
Shkurt	1.5
Mars	1.4

Interpretim



- Shkurti = **pikë kulmore tensioni**
- Polarizimi mbetet i lartë edhe pas kulmit = **normalizim i konfliktit**
- Diskursi i pozitës = **mbrojtës ndaj drejtësisë**
- Diskursi i opozitës = **delegitimues ndaj qeverisë**


- Konflikti nuk po bie → po bëhet **strukturor**

Klima dhe polarizimi i gjuhës lidhen me:

- hetime të nivelit të lartë
- ndërhyrje ligjore
- protesta

Analizë e riskut

Fusha	Niveli	Trendi i riskut
Sundimi i ligjit	I lartë	↑
Stabiliteti	I lartë	↑
Reforma në Drejtësi	Mesatare	→
Integrimi në BE	I moderuar	→



Konkluzione:

Shqipëria nuk është në krizë të papritur, por në një **fazë të konsolidimit të polarizimit politik.**

- Diskursi po bëhet më pak institucional
- Konflikti po bëhet **instrument politik "normal"**
- Rreziku kryesor - **erozion gradual i besimit në institucione**